

VENDIM
Nr. 504, datë 10.6.2015

PËR MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TË NDËRTIMIT TË CENTRALIT ELEKTRIK EOLIK, DHËNË SHOQËRISË “ERA MILOT”, SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 2, të nenit 34/1, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik eolik, dhënë shoqërisë “Era Milot”, sh.p.k., sipas tekstit dhe koordinatave të zonave të përcaktuara në hartën përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRISE

AUTORIZIM

Nr. _____ datë _____.____.2015

PËR NDËRTIMIN E CENTRALIT ELEKTRIK EOLIKNGA SHOQËRIA ERA MILOT SH.P.K.

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 34/1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar dhe në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1701, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar,

Duke pasur parasysh se:

a) Shoqëria “Era Milot” sh.p.k. është pajisur me autorizimin paraprak nr. 1, datë 15.3.2015 nga MEI, për ndërtimin e centralit elektrik eolik në komunën Fushë Kuqe, rrethi Kurbin, qarku Lezhë;

b) “Era Milot” sh.p.k. ka paraqitur studimin e plotë të fizibilitetit teknik, ekonomik, financiar dhe mjedisor e social, bazuar në të dhëna të zonës së zbatimit të projektit;

c) “Era Milot” sh.p.k. ka paraqitur planin e biznesit të projektit;

d) “Era Milot” sh.p.k. ka paraqitur grafikun e zbatimit të projektit;

e) OST sh.a. ka miratuar pikën e lidhjes me shkresën nr. 5738/1, datë 1.10.2014;

f) “Era Milot” sh.p.k. ka marrë lejet dhe autorizimet mjedisore nga institucionet përgjegjëse;

g) “Era Milot” sh.p.k. ka paraqitur dokumen-tacionin që provon të drejtat e pronësisë mbi tokën që do të përdoret për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë autorizon shoqërinë “Era Milot” sh.p.k., e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, me nr. NUIS L31408009C, me seli në adresën: rruga “Sami Frashëri”, nd. 14, h. 11, ap. 8, njësia bashkiake nr. 10, Tiranë, për ndërtimin e centralit elektrik eolik në përputhje me kushtet dhe karakteristikat e mëposhtme:

- Fuqi të instaluar, 36 MWp;
- Prodhimtari të pritshme totale të energjisë elektrike prej 104.400 MWh/vit;
- Numri total i kullave eolike është 12 copë;
- Kapaciteti i një turbine gjeneruese (aerogeneratori) është 3 MW;
- Lartësia e kullës eolike është 92.5 m;
- Tipi i turbinës gjeneruese SIEMENS;
- Diametri i rotorit 113 m;
- Numri i orëve të punës në një vit rreth 3.000 orë pune;
- Shpejtësia mesatare vjetore e erës është 6.8 m/s;

Pika e lidhjes me rrjetin e transmetimit do të jetë në një çarje të linjës ajrore 110 kV Fushë-Kuqe - Laci 1, sipas skemës primare hyrje-dalje 110 kV dhe me trakte të plotë sipas standardeve IEC dhe EN, (e përcaktuar kjo në shkresën nr. DPZH/ZPT 5738/1 prot, e datës 1/10/2014, për miratimin në parim të

kërkesës për rishikimin e pikës së lidhjes), përgjigje e OST-së për shoqërinë “Era Milot” sh.p.k.;

- Jetëgjatësia e pritshme e parkut eolik është 20 - 30 vjet;

- Vlera e investimit rreth 54 milion €.

1. Shoqëria “Era Milot” sh.p.k. do të përfundojë ndërtimin e centralit elektrik eolik brenda 8 muajve nga data e fillimit të punimeve.

2. “Era Milot” sh.p.k. të paraqesë në MEI projektin e plotë të zbatimit teknik brenda një periudhe prej 1 (një) muaji nga data e hyrjes në fuqi të këtij autorizimi.

3. “Era Milot” sh.p.k. është e detyruar të raportojë çdo 3 muaj pranë MEI-t mbi ecurinë e ndërtimit të centralit elektrik me erë, duke filluar nga data e fillimit të ndërtimit. MEI ka të drejtë t’i kërkojë “Era Milot” sh.p.k. çdo informacion që e konsideron të nevojshëm lidhur me zbatimin e kushteve të këtij autorizimi.

4. Brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij autorizimi, midis “Era Milot” sh.p.k. dhe MEI do të nënshkruhet një kontratë lidhur me afatet e realizimit dhe penaltitetet në rast mosrealizimi në kohë apo transferimi të autorizimit.

5. “Era Milot” sh.p.k. në përputhje me VKM nr. 1701, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar, do t’i paguajë çdo vit ministrisë përgjegjëse për energjinë një *royalty* të barabartë me 2% të sasisë së energjisë vjetore të prodhuar nga centrali eolik ose vlerën në lekë të kësaj sasive energjie së bashku me çdo përfitim aksesor të shoqërisë në lidhje me sasinë e *royalty* prej 2% efektivisht të përfituar në bazë të incentivave të tregut të energjisë së rinovueshme.

6. Shoqërisë i rezervohet një zonë buferike me një rreze prej 50 metrash nga kufiri i centralit sipas koordinatave të zonës ku pozicionohen komponentët.

7. Autorizimi mund të revokohet nga ministria përgjegjëse për energjinë në rastet e mëposhtme:

a) Me kërkesë me shkrim të “Era Milot” sh.p.k., për raste të veçanta të justifikuara;

b) “Era Milot” sh.p.k. nuk respekton detyrimet dhe kriteret e përcaktuara në këtë autorizim dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi prej ministrisë përgjegjëse për energjinë, nuk paraqet arsyet justifikuese të dokumentuara për mosrealizimin dhe nuk merr masat e nevojshme për të përmbushur detyrimet përkatëse;

c) “Era Milot” sh.p.k. nuk informon MEI mbi arsyet që mund të shpien në vonesa ndaj realizimit të ndërtimit të paktën 60 (gjashtëdhjetë ditë) përpara periudhës së përfundimit të afatit të ndërtimit;

d) Vërtetohet se deklaratimet e “Era Milot” sh.p.k. nuk janë të vërteta;

e) Kur për “Era Milot” sh.p.k. kanë filluar procedurat e falimentimit ose likuidimit, sipas ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”;

f) “Era Milot” sh.p.k. për arsye të shkaktuara nga ajo vetë nuk ka respektuar programin e punimeve dhe brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi prej ministrisë përgjegjëse për energjinë, nuk paraqet arsyet për mosrealizimin e detyrës dhe nuk paraqet masat që do të ndërmarrë për të përfunduar centralin elektrik me erë në datën e përcaktuar;

g) “Era Milot” sh.p.k. nuk respekton detyrimin për informimin dhe nëse brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pas njoftimit paraprak nga MEI për mosdhënie informacioni, përsëri nuk dërgon informacionin e kërkuar;

h) Në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga VKM nr. 1701, datë 17.12.2008, “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”, të ndryshuar.

8. Kohëzgjatja e këtij autorizimi është 25 vjet duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij autorizimi.

9. Ky autorizim hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Ministrave.

MINISTRI I ENERGJISË DHE INDUSTRIË

Damian Gjicknuri

Aktualisht layout-ti eshte i perbere nga 12 turbina si paraqitet ne Fig. 2.3 dhe ne Tab. 2.1.



Fig. 2.3 – Layout-i i parkut eolik

WTG	UTM 34T Datum WGS 84		Koordinatat Gjeografike		Gauss Krueger (S-42 ALB)		
	X (E)	Y (N)	Lat.	Lon.	X	Y	Z
1C	385.755	4.612.708	41° 39' 30.2646" N	19° 37' 45.9461" E	4614685.331	4385838.715	1
2C	385.564	4.612.274	41° 39' 16.0974" N	19° 37' 37.9888" E	4614251.155	4385647.637	1
3C	385.931	4.611.667	41° 38' 56.6099" N	19° 37' 54.2681" E	4613643.909	4386014.786	1
4C	385.829	4.610.320	41° 38' 12.8926" N	19° 37' 50.7844" E	4612296.364	4385912.744	0
5C	385.373	4.609.993	41° 38' 2.0572" N	19° 37' 31.3053" E	4611969.232	4385456.560	0
6C	385.700	4.609.857	41° 37' 57.8173" N	19° 37' 45.5282" E	4611833.177	4385783.692	0
7C	386.115	4.613.079	41° 39' 42.4763" N	19° 38' 1.2531" E	4615056.481	4386198.860	0
8C	387.849	4.612.131	41° 39' 12.6298" N	19° 39' 16.8505" E	4614108.097	4387933.562	0
9C	387.582	4.610.571	41° 38' 21.9246" N	19° 39' 6.3646" E	4612547.465	4387666.454	0
10C	387.314	4.609.472	41° 37' 46.1628" N	19° 38' 55.5277" E	4611448.020	4387398.345	0
11C	387.370	4.608.431	41° 37' 12.4454" N	19° 38' 58.6515" E	4610406.599	4387454.368	0
12C	386.644	4.608.370	41° 37' 10.0983" N	19° 38' 27.3296" E	4610345.574	4386728.074	0

Tab. 2.1– Pozicioni i aerogjeneratoreve te parkut Eolik Milot

